



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr.276, datë 25.05.2023

PËR

**DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR
LËVIZJEN PARALELE, TË KANDIDATES ZNJ. {...}, PËR POZICIONIN E LIRË NË
FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR.19, DATË 18.01.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidates znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit, për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 19, datë 18.01.2023,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 18.01.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.19, datë 18.01.2023 kandidoi edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidati) gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat¹ (në kohën e kandidimit e transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë).

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 19/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

5. Me Vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, *“Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr.11..; ;nr.24 ..., datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...Për kandidaten znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj; ...”.

6. Më datë 13.03.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, *“Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”* (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹ Nga data 01.05.2023 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes komunikimit elektronik, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

9. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me komunikimin elektronik datë 15.03.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}.

10. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, informacioni u kërkua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila ktheu përgjigje me shkresën nr.710 prot., datë 23.03.2023.

II. SITUATA FAKTIKE DHE ARSYETIMI LIGJOR

11. Gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit për kandidaten, rezultoi që Këshilli me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 ka vendosur transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

12. Rrethana e faktit si më sipër, transferimi i gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pikërisht gjykata për të cilën ajo ka kandiduar për lëvizje paralele (në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile), ndikon në ecurinë e procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore dhe në përfundim në kualifikimin e kësaj kandidateje.

13. Me realizimin e transferimit të gjyqtares, konstatohet se ka rënë dhe shkak për të cilin kishte filluar procedura e verifikimit në kuadër të lëvizjes paralele. Për pasojë kjo procedurë verifikimi nuk mund të vazhdojë dhe duhet të përfundohet pa një vendim përfundimtar.

14. Referuar nenit 97, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikohet që “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

15. Referuar nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet që: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”. Ndërsa sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

III. KONKLUSIONE

16. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit Këshillit nr.19, datë 18.01.2023, si dhe përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është rasti për përfundimin pa vendim përfundimtar të të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore, të kandidimit për lëvizjen paralele të znj. {...}.

17. Bazuar në sa më lart është parashtruar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja e ka realizuar interesin e saj mbi lëvizjen paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, me anë të procedurës së transferimit me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 të Këshillit. Nisur nga kjo, çmohet se është vendi për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të znj. {...}.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 90, pika 3 dhe nenet 93-96 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97/3 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në vendimin e tij nr. 19, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”,

VENDOSI:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidates znj. {...}, për shkak të transferimit të kandidates pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 të Këshillit.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR